

## **MILSPED ALBANIA SHPK**

---

**Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor 2020  
(se bashku me Raportin i Audituesit te Pavarur)**

**PERMBAJTJA****Faqja**

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	i,ii
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBYES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	3
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	4
SHENIMET SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE	5-34

## **RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

Për Drejtimin e Shoqërisë Milsped Albania Shpk

### **Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Milsped Albania Shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2020, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### **Baza për opinionin**

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA) që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

### **Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjese e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marreveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në lidhje me to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

**Nexia AL**

Auditues Ligjor

Orjana Kalaja

Tirana, Albania

29 mars 2020



**MILSPED ALBANIA SHPK**  
**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBYES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE**  
**PER PERIUDHEN QE MBYLLET ME 31 DHJETOR 2020**  
*(Vlerat ne Leke)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	18	585,675,652	472,854,948
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	19	(914,350)	(1,164,691)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	20	(441,483,153)	(335,005,909)
Shpenzime personeli	21	(59,247,595)	(57,621,588)
Shpenzime amortizimi dhe zhvleresimi	6,7,8	(47,128,405)	(56,899,404)
Shpenzime provigjoni per borxhin e keq		(655,985)	(1,960,098)
Shpenzime financiare, neto	22	(3,329,336)	(9,584,124)
Fitimi / (humbja) nga kurset e kembimit	23	(1,226,418)	402,259
<b>Fitimi/(Humbja) Para Tatimit</b>		<b>31,690,410</b>	<b>11,021,393</b>
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	24	(6,650,506)	(3,149,543)
<b>Fitimi neto per periudhen</b>		<b>25,039,904</b>	<b>7,871,850</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave/(humbjes) gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>25,039,904</b>	<b>7,871,850</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithepershiresë duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 34 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Keto pasqyra financiare jane pergatitur nga dhe miratuar ne 29 mars 2021 nga:

Pergatitur nga:

Elpina Caci  
Menaxhere e Finances

Miratuar nga:

Marko Divljan  
Administrator

**MILSPED ALBANIA SHPK**  
**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**  
**PER PERIUDHEN QE MBYLLET ME 31 DHJETOR 2020**  
*(Vlerat ne Leke)*

	Shënime	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
<b>Aktivët</b>			
<b>Aktivët afatgjata</b>			
Aktivët afatgjata materiale	6	31,524,505	76,475,776
Aktivët afatgjata jo materiale	7	1,010,384	1,274,486
Aktivët afatgjata ne perdorim	8	195,771,852	177,840,552
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>228,306,741</b>	<b>255,590,814</b>
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Te drejta te arketueshme tregtare dhe te tjera te arketueshme	9	138,754,924	98,723,114
Inventari	10	12,537	117,315
Tatim fitimi i parapaguar		-	2,509,016
Mjete monetare dhe te ngjashme	11	33,131,666	6,047,947
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>171,899,127</b>	<b>107,397,392</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>400,205,868</b>	<b>362,988,206</b>
<b>Kapitali dhe Detyrimet</b>			
Kapitali aksionar		56,108,000	56,108,000
Fitim/(Humbja) e akumuluar		3,935,924	-
Fitim/(Humbja) e vitit		25,039,904	7,871,850
<b>Totali i kapitalit të vet</b>	12	<b>85,083,828</b>	<b>63,979,850</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Huate nga institucionet financiare afatgjata	13	-	22,830,764
Detyrime per qirane financiare afatgjate	14	150,707,185	140,181,918
<b>Totali- Detyrime afatgjata</b>		<b>150,707,185</b>	<b>163,012,682</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Huate nga institucionet financiare afatshkurtra	13	28,184,164	12,880,062
Detyrime per qirane financiare afatshkurter	14	45,066,476	39,892,609
Furnitore dhe te tjera detyrime	15	85,242,441	79,451,898
Te pagueshme ndaj punonjesve	16	1,389,754	1,168,387
Detyrime tatimore	17	4,532,020	2,602,718
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>164,414,855</b>	<b>135,995,674</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>315,122,040</b>	<b>299,008,356</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>400,205,868</b>	<b>362,988,206</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 34 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

**MILSPED ALBANIA SHPK**  
**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL**  
**PER PERIUDHEN QE MBYLLET ME 31 DHJETOR 2020**  
*(Vlerat ne Leke)*

---

	<b>Kapitali i nenskruar</b>	<b>Fitimi i pashperndare</b>	<b>Fitimi i vitit</b>	<b>Totali i kapitalit</b>
<b>Gjendje me 1 Janar 2019</b>	<b>56,108,000</b>	<b>6,359,738</b>	<b>24,060,753</b>	<b>86,528,491</b>
Kalim i fitimeve te vitit tek fitimi i pashperndare	-	24,060,753	(24,060,753)	-
Fitimi i vitit	-	-	7,871,850	<b>7,871,850</b>
Pagese Dividenti	-	(30,420,491)	-	<b>(30,420,491)</b>
<b>Gjendje me 31 Dhjetor 2019</b>	<b>56,108,000</b>	<b>-</b>	<b>7,871,850</b>	<b>63,979,850</b>
Kalim i fitimeve te vitit tek fitimi i pashperndare	-	7,871,850	(7,871,850)	-
Fitimi i vitit	-	-	25,039,904	<b>25,039,904</b>
Pagese Dividenti	-	(3,935,926)	-	<b>(3,935,926)</b>
<b>Gjendje me 31 Dhjetor 2020</b>	<b>56,108,000</b>	<b>3,935,924</b>	<b>25,039,904</b>	<b>85,083,828</b>

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 34 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

**MILSPED ALBANIA SHPK**  
**PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE**  
**PER PERIUDHEN QE MBYLLET ME 31 DHJETOR 2020**  
*(Vlerat ne Leke)*

	Viti i mbyllur me 2020	Viti i mbyllur me 2019
<b>Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:</b>		
Fitimi/Humbja e vitit	25,039,904	7,871,850
<b>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</b>		
Shpenzime zhvleresimi dhe amortizimi	47,128,405	56,899,404
Provizione zhvleresimi te arketueshme	655,985	1,960,098
Shpenzime per tatimin jomonetar	6,650,506	3,149,543
<b>Rregullime ne kapitalin qarkullues</b>		
Zbritje/(rritje) ne inventar	104,778	776,008
Rritje/(zbritje) ne llogari te arketueshme	(40,687,795)	(23,905,967)
Rritje/(zbritje) ne shpenzime te shtyra	-	653,179
Rritje/(zbritje) ne detyrime per qirane financiare	15,699,134	180,074,527
Rritje/(zbritje) ne detyrimet e pagueshme	5,790,543	19,216,654
Rritje/(zbritje) ne detyrime tatimore	1,929,302	1,935,774
Rritje/(zbritje) ne detyrime ndaj punonjesve	221,367	63,215
Tatim fitimi i paguar	(4,141,490)	(5,096,709)
<b>Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit</b>	<b>58,390,639</b>	<b>243,597,576</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit</b>		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(1,166,574)	(3,082,276)
Shitje aktivesh afatgjata materiale	36,911,437	4,241,822
E derjta per perdorimin e aktiveve	(55,589,195)	(214,867,733)
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit</b>	<b>(19,844,332)</b>	<b>(213,708,187)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit</b>		
Hyrje / (Pagesa) neto nga huamarrja	(7,526,662)	(16,898,819)
Pagese Dividenti	(3,935,926)	(30,420,491)
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit</b>	<b>(11,462,588)</b>	<b>(47,319,310)</b>
<b>Rritje/(Renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare</b>	<b>27,083,719</b>	<b>(17,429,921)</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fillim	6,047,947	23,477,868
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fund</b>	<b>33,131,666</b>	<b>6,047,947</b>

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 34 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

**MILSPED ALBANIA SHPK**  
**SHENIME SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE**  
**PER PERIUDHEN QE MBYLLET ME 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat ne Leke)*

## **1 Informacion i pergjithshem**

Shoqeria Milsped Albania Sh.p.k (“Shoqeria”) u themelua si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 03 Dhjetor 2013 ne Qendren e Kombetare te Regjistrimit dhe ka per objekt transportin e mallrave dhe te udhetareve me mjetet e shoqerise ose te te treteve, brenda dhe jashte vendit, si dhe ndermjetesimin ne transport.

Zyra e regjistrimit te Shoqerise eshte Kamez Tirane, Rruga Gryka e Kacanikut, Godina e Parkut Logjistik, Autostrada Tirane- Durrës, km 5.

Kapitali i shoqerise eshte 56,108,000 lek dhe perbehet nga 100 pjese me vlere 561,080 lek nje pjese

<b>Emri i Ortakut</b>	<b>Vlera e kapitalit</b>	<b>Numri i pjeseve</b>	<b>% e kapitalit</b>	<b>Vlera nominale e nje pjese</b>
Milsped	28,054,000	50	50%	561,080
Balfin	28,054,000	50	50%	561,080
<b>Totali</b>	<b>56,108,000</b>	<b>100</b>	<b>100%</b>	<b>561,080</b>

Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 Dhjetor 2020 ishte 58 punonjes (2019: 60 punonjes).

Pasqyrat financiare te shoqerise per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020 jane miratuar nga Drejtimi i Shoqerise ne 29 mars 2021.

## **2 Bazat e pergatitjes**

### **(a) Baza e perputhshmerise**

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (“SNRF”) publikuar nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (“BSNK”) dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Nderkombetare te Raportimit Financiar (“KINRF”) te BSNK. Zbatimi i SNRF-ve eshte sipas Ligjit Nr.25 / 2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 17. date 16.01.2019.

### **(b) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare jane pergatitur duke u bazuar ne koston historike.

### **(c) Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat Financiare jane pasqyruar ne “Lek” e cila eshte monedha funksionale e shoqerise.

### **(d) Perdorimi i gjykimit dhe i vleresimeve**

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon qe drejtimi i shoqerise te beje gjykime. vleresime dhe supozime qe mund te ndikojne ne aplikimin e politikave si dhe vlerave te raportuara te aktiveve dhe detyrimeve. te ardhurave dhe shpenzimeve. Vleresimet dhe supozimet kryesore jane rishikuar ne menyre te vazhdueshme.

Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi rishikohet dhe ne çdo periudhe te ardhshme ne te cilen mund te kete ndikim.

### **3 Politika kontabel te rendesishme**

#### **3.1 Aplikimi i Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar te reja dhe te rishikuara**

##### **a. Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale**

Standardet, amendimet dhe interpretimet në vijim, hyjnë në fuqi për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2020 ose pas kësaj date:

- Perditesime te Referencimeve ne Kuadrin Konceptual te standardeve SNRF 1 Janar 2020;
- Perkufizimi i nje Biznesi (Perditesime te SNRF 3) 1 Janar 2020;
- Perkufizimi i te qenit Material (Perditesime ne SNK 1 dhe SNK 8) 1 Janar 2020;
- Reforma e Normës së Interesit Referuese (Perditesime në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7) 1 Janar 2020.

Standardet e reja që mund të adoptohen më herët:

- Koncesionet e Qirave që lidhen me COVID-19 (Ndryshim në SNRF 16) 1 Qershor 2020

Përveç sa me sipër nuk ka patur standarde apo interpretime të tjera të reja, të cilat kanë hyrë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2020 ose pas kësaj date, që të kenë efekt të qenësishëm në pasqyrat financiare të kompanisë.

##### **b. Standardet dhe interpretimet e emëtuara por ende të pa përvetësuara**

Nje numer standardesh, amendimesh dhe interpretimesh hyjnë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2021 ose pas kësaj date, e megjithatë Shoqëria nuk i ka aplikuar keto standarde të reja ose të rishikuara në përgatitjen e ketyre pasqyrave financiare si me poshte vijon:

Efektive qe prej 1 Janarit 2021:

- Kontratat e Sigurimit SNRF 17;
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtër ose afatgjatë (Perditesime në SNK 1) ende e papërvetësuar; Shitja ose kontributi në aktive ndërmjet Investitorit dhe Bijes ose Shoqërisë së Perbashkët (Perditesime në SNRF 10 dhe SNK 28).

#### **3.2 Parimi i vijimësisë**

Shpërthimi i pandemisë COVID-19 dhe masat e miratuara nga qeveria e Shqipërisë për të zbutur përhapjen e pandemisë kanë ndikuar në Shoqërinë. Këto masa kërkuan që Shoqëria të kufizojë aktivitetin e saj. Kjo ka ndikuar negativisht në performancën financiare të Shoqërisë për vitin dhe gjithashtu pozicionin e saj të likuiditetit.

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020, Shoqëria njohu një fitim / humbje neto prej 25,039,904 Lek (31 Dhjetor 2019: 7,871,850 Lek). Aktivet afatshkurtër neto të Shoqërisë në 31 Dhjetor 2020 ishin 48,699,161 Lek (31 Dhjetor 2019: 28,598,281 Lek).

Bazuar në pozicionin e likuiditetit të Shoqërisë në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, si dhe në pasigurinë që rrethon vazhdimësinë e ardhshme të shpërthimit pandemik, drejtimi vlerëson se, nuk ka nevojë për financim shtesë për të përmbushur detyrimet e saj financiare.

Ekziston ende një pasiguri e rëndësishme se si pandemia do të ndikojë në biznesin e Shoqërisë në periudhat e ardhshme.

### **3 Politika kontabel te rendesishme (vazhdim)**

#### **3.2 Parimi i vijimesise (vazhdim)**

Kufizimet dhe rregulloret e COVID-19 kanë ndryshuar gjatë gjithë periudhës bazuar në përhapjen e virusit në Shqipëri. Që nga data e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, është e vështirë të vlerësosh kufizimet e mundshme që do të zbatohen në Shqipëri, dhe si rezultat, është e vështirë të përgatitësh një gamë të mundshme skenarësh për çdo ndikim të mundshëm në operacionet e Shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Megjithëse, ka ende paqartësi se si zhvillimi i ardhshëm i shpërthimit pandemic do të ndikojë Shoqërinë, menaxhmenti ka një besim të arsyeshëm se ajo ka burime të përshtatshme për ti përballuar.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimesisë dhe nuk përfshijnë ndonjë rregullim të vlerës kontabel dhe klasifikimit të aktiveve, pasiveve dhe shpenzimeve të raportuara që përndryshe mund të kërkojnë nëse baza e parimit të vijimesisë nuk do të ishte e përshtatshme.

#### **3.3 Transaksione ne monedhe te huaj**

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Te gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i kembimit qe rezultojne nga kryerja e ketyre transaksioneve dhe nga rivleresimi i zerave monetare ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fundit te vitit njihen ne fitim ose humbje.

Zerat jo-monetare nuk ri kembehen ne fund te periudhes dhe maten me kosto historike (kembehen duke perdorur kursin e kembimit ne date kur eshte kryer transaksioni), pervec rasteve kur zerat jo-monetare maten me vlere te drejte te cilat kembehen duke perdorur kurset e kembimit ne daten kur eshte percaktuar vlera e drejte.

Kurset zyrtare te aplikuara (Lek kundrejt monedhave te tjera te huaja) per monedhat kryesore ne daten e raportimit jane si me poshte:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
USD	100.84	108.64
EUR	123.7	121.77

#### **3.4 Aktivitet afatgjata materiale**

##### *(i) Njohja dhe matja*

Zerat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin nese ka. Kostot historike perfshijne shpenzimet te lidhura drejtperdrejte me blerjen e aktivitet. Kostot e aktiveve te ndertuara vete perfshijne koston e materialeve dhe te punes se shpenzuar, si dhe cdo kosto tjeter qe lidhet me sjelljen e aktivitet ne kushte pune per qellimin per te cilin jane krijuar, kostot e cmontimit dhe zhvendosjes se aktivitet dhe kthimit te vendit te punes ku aktivitet ishte vendosur ne gjendjen e tij fillestare dhe kostot e huamarrjes qe lidhen me aktivitetin e kualifikuar per t'u kapitalizuar. Kur pjese te ndryshme te aktiveve afatgjata materiale kane jetegjatesi te ndryshme te dobishme, ato kontabilizohen si pjese me vete (komponente kryesore) te aktiveve afatgjata materiale.

##### *(ii) Kostot e mepasshme*

Kosto e zevendesimit te pjeseve te aktiveve afatgjata materiale i shtohet vleres se mbartur te aktivitet vetem ne qofte se parashikohet qe kjo pjese te sjelle perfitime ekonomike ne te ardhmen per shoqerine dhe kosto mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te perditeshme te aktiveve materiale afatgjata njihen ne shpenzimet e periudhes kur ndodhin.

**MILSPED ALBANIA SHPK**  
**SHENIME SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE**  
**PER PERIUDHEN QE MBYLLET ME 31 DHJETOR 2020**

*(Vlerat ne Leke)*

---

**3 Politika kontabel te rendesishme (vazhdim)**

**3.4 Aktivitet afatgjata materiale (vazhdim)**

*(iii) Zhvleresimi (Amortizimi)*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden lineare apo zbritese te amortizimit. mbi jeten e vleresuar te çdo pjese te aktivitet afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitet. Toka nuk amortizohet.

<b>Kategoria</b>	<b>Metoda e amortizimit</b>	<b>Norma e amortizimit</b>
Makineri dhe pajisje	Mbi vleren kontabel neto	20%
Mjete transporti	Mbi vleren kontabel neto	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Mbi vleren kontabel neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vleren kontabel neto	25%

Vlera e mbetur dhe jetegjatesia e aktiveve afatgjata materiale shqyrtohet. dhe rregullohet nese eshte e pershtatshme. ne çdo date te Pasqyres se pozicionit financiar. Vlera kontabel e nje aktivitet shpenzohet menjehere deri ne shumen e rikuperueshme. nese vlera kontabel e aktivitet eshte me e madhe se shumata e vleresuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga shitja percaktohet duke krahasuar te ardhurat me vleren kontabel. Keto jane te perfshira ne fitimin ose humbjen e periudhes financiare.

**3.5 Aktivitet afatgjata jo-materiale**

Aktivitet afatgjata jo-materiale te blera nga shoqeria paraqiten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetere nga renia ne vlere (nese ka) . bazuar ne jetegjatesine e vleresuar pas dates se ciles ato jane te gatshme per perdorim. Jetegjatesia dhe metoda e amortizimit te aktiveve afatgjata jo-materiale shqyrtohet. ne çdo date te pasqyres se pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh ne periudhat e ardhshme.

<b>Kategoria</b>	<b>Metoda e amortizimit</b>	<b>Norma e amortizimit</b>
Aktivitet afatgjata jo materiale	Mbi vleren kontabel neto	25%

Vlera kontabel e aktiveve jo-financiare te shoqerise . pervec inventarit dhe aktiveve tatimore te shtyra. shqyrtohen ne çdo date te pasqyres se pozicionit financiar per te percaktuar nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Nese ndonje tregues i tille ekziston . atehere vlera e rikuperueshme e aktivitet rivleresohet. Kur vlera kontabel e tejkalon vleren e rikuperueshme. njihet nje humbje nga zhvleresimi. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

**3.6 Zhvleresimi i aktiveve jo-financiare**

Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabel e nje aktivitet ose njesise gjeneruese te mjeteve monetare eshte me e vogel se vlera e tij e rikuperueshme. Nje njesi gjeneruese e mjeteve monetare eshte grupi me i vogel i identifikueshem i aktiveve qe gjeneron flukse monetare ne menyre te pavarur nga aktivitet apo grupet e tjera te aktiveve. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje. Vlera e rikuperueshme e nje aktivitet ose e njesise gjeneruese te mjeteve monetare eshte vlera me e madhe midis vleres ne perdorim dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Ne vleresimin e vleres ne perdorim. flukset monetare te ardhshme skontoohen per ti sjelle ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme skontimi para taksave e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rrezikun specifik te aktivitet.

### **3 Politika kontabel te rendesishme (vazhdim)**

#### **3.6 Zhvleresimi i aktiveve jo-financiare (vazhdim)**

Ne lidhje me aktivet e tjera, nje humbje nga zhvleresimi rimerret ne qofte se ka ndonje tregues qe ky zhvleresim nuk ekziston me dhe ka pasur ndryshime ne vleresimet e perdorura per te percaktuar vlerat e rikuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi rimerret deri ne masen qe vlera kontabel e aktivitet nuk e kalon vleren kontabel qe do te ishte percaktuar, neto nga amortizimi dhe zhvleresimi, ne qofte se asnje humbje nga zhvleresimi nuk eshte njohur.

#### **3.7 Inventaret**

Inventaret maten me vleren me te vogel midis koshtos dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme eshte çmimi i vleresuar i shitjes ne rrjedhen normale te biznesit, minus koshtot e çmuara te perfundimit dhe koshtot e çmuara qe duhen per realizimin e shitjes.

Koshtot e inventarit percaktohen duke u bazuar ne metoden e mesatares se ponderuar, e cila perfshin te gjitha koshtot e blerjes, transportit, tarifave doganore dhe sigurimit gjate transportit, koshtot e konvertimit dhe çdo kosht tjetër qe lidhet me inventarin per te sjelle ate ne vendin dhe kushtet e punes.

#### **3.8 Instrumentet financiare**

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqeria behet pale e dispozitive kontraktuale te instrumentave financiare dhe matet fillimisht me vleren e drejte te rregulluar per koshtot e transaksionit, me perjashtim te atyre te mbajtura me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes te cilat fillimisht jane te matura me vleren e drejte dhe koshtot e transaksionit jane shpenzuar ne fitimin ose humbjen.

##### ***i. Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare:***

SNRF 9 permban tre kategori kryesore te klasifikimit per aktivet financiare: matur me koshtin e amortizuar, vleren e drejte nepermjet te ardhurave te tjera permbledhese ose me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 ne pergjithesi bazohet ne modelin e biznesit ne te cilin menaxhohet nje aktiv financiar dhe karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale te aktivitet financiar. SNRF 9 permban tre kategori kryesore te klasifikimit per aktivet financiare: te matura me koshtin e amortizuar, vleren e drejte nepermjet te ardhurave te tjera permbledhese ose me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes. Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 bazohet pergjithesisht ne modelin e biznesit ne te cilin nje aktiv financiar menaxhohet dhe karakteristikave te flukset monetare kontraktuale.

Modeli i biznesit percaktohet per aktivet financiare individuale (ne nivel individual) bazuar ne te gjitha evidencen perkatese per aktivitetet qe Shoqeria ndermerr per te arritur objektivin e caktuar per aktivin individual ne dispozicion ne daten e vleresimit. Faktoret qe konsiderohen nga Shoqeria ne percaktimin e modelit te biznesit perfshijne: qellimin e aktivitet, pervojen e kaluar ne menyren se si jane arketuar flukset e mjeteve monetare per aktivet perkatese, si vleresohen dhe menaxhohen rreziket, si vleresohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen menaxheret.

Shoqeria identifikoi se:

- Rreziket kryesore te modelit te biznesit jane ne perputhje me modelin “mbajtja per te mbledhur”, me fokus ne rrezikun e kredise. Asnje peshe nuk i jepet riskut te çmimit ose vleres se drejte;
- Deri tani nuk ka pasur asnje shitje. Shitjet do te ndodhin vetem ne pergjigje te perkeqesimit te riskut te kredise, qe rezulton nga shkeljet e kriterave te brendshme te riskut te kredise. Keto shitje do te ishin ne perputhje me nje model biznesi “mbaj per te mbledhur”. Nje shitje per shkak te plotesimit te nevojave te likuiditetit do te ishte rastesore.

### **3 Politika kontabel te rendesishme (vazhdim)**

#### **3.8 Instrumentet financiare (vazhdim)**

##### *i. Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare (vazhdim)*

Prandaj, modeli i biznesit qe lidhet me Llogarite e arketueshme konsiderohet te jete “mbajtje per te mbledhur”.

Kur modeli i biznesit ka si objektiv mbajtjen e aktiveve per mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ose mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe per te shitur, Shoqeria vlereson nese flukset e mjeteve monetare perfaqesojne vetem pagesa principali dhe interesi ("VPPI"). Gjate ketij vleresimi, Shoqeria konsideron nese flukset e mjeteve monetare kontraktuale jane ne perputhje me nje marreveshje baze te huadhenies, pra interesi perfshin vetem shumen per riskun e kredise, vleren kohore te parase, rreziqet e tjera baze te huadhenies dhe marzhin e fitimit.

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj riskut ose paqendrueshmerise qe nuk eshte ne perputhje me nje marreveshje baze te huadhenies, aktivi financiar klasifikohet dhe matet me VDNFH. Vleresimi i VPPI kryhet ne njohjen fillestare te nje aktivi dhe nuk rivleresohet me pas.

Percaktimin nese flukset e mjeteve monetare te nje aktivi financiar jane vetem pagesa te principalit dhe interesit kerkon gjykim. Llogarite e arketueshme te Shoqerise perfshijne nje fluks te vetem te parase, pagesen e shumes qe rezulton nga nje transaksion ne fushen e SNRF 15, qe konsiderohet te jete principali. Rrjedhimisht, flukset monetare qe rrjedhin nga te arketueshmet plotesojne testin VPPI te pagesave te principalit dhe interesit pavaresisht se perberesi i interesit eshte zero.

##### *ii. Zhvleresimi i aktiveve financiare*

Shoqeria mat humbjet e pritshme te kredise per aktivet e matura me koston e amortizuar, qe perfshijne llogarite e arketueshme dhe te tjera te arketueshme dhe mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre.

Shoqeria ka zgjedhur te mase humbjet e pritshme te kredise per llogarite e arketueshme ne nje shume te barabarte me totalin e HPK pergjate jetes se aktivitetit, duke perdorur nje matrice provizionimi ne te cilen fondet per humbjet llogariten bazuar mbi norma te humbjeve te pritshme per llogarite e arketueshme qe i perkasin periudhave te ndryshme te maturimit apo vonesave.

Normat e humbjes se pritshme te kredise bazohen ne profilin e pagesave te shitjeve per nje periudhe 3 vjeçare perpara 1 janarit 2020 dhe humbjeve korresponduese historike te kredise gjate asaj periudhe. Normat historike te humbjeve korrigojohen per te pasqyruar informacionin aktual dhe te ardhshem per faktoret makroekonomike qe mund te ndikojne ne aftesine e klienteve per te shlyer llogarite e arketueshme.

Aktivitetet financiare fshihen teresisht ose pjeserisht, kur Shoqeria ka kryer çdo perpjekje per rimarrjen dhe ka arritur ne perfundimin se nuk ka pritshmeri te arsyeshme per rimarrjen. Fshirja perfaqeson nje rast te çregjistrimit. Treguesit qe nuk ka pritshmeri te arsyeshme te rimarrjes perfshijne shkelje te kushteve te kontrates si vonesa ne pagesa ose ngjarje te mospagimit, paaftesi paguese dhe falimentim. Shoqeria mund te fshije aktivitetet financiare qe jane ende subjekt i zbatimit me force te marreveshjes ku Shoqeria kerkon te rikuperoje shumet qe jane te arketueshme sipas termave kontraktuale, dhe megjithate, nuk ka pritshmeri te arsyeshme per marrjen e tyre.

Shoqeria çregjistron aktivitetet financiare kur (a) aktivitetet shlyhen ose te drejtat per flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet perfundojne ose (b) Shoqeria ka transferuar te drejtat per arketimin e flukseve monetare nga aktivitetet financiare ose ka hyre ne nje marreveshje likuidimi nderkohe qe (i) transferon thelbesisht te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise se aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise, por nuk ruan kontrollin e ketyre aktiveve.

Kontrolli ruhet ne qofte se pala tjetere nuk ka aftesine praktike per te shitur aktivin ne teresi tek nje pale e trete e palidhur pa pasur nevojte te vendose kufizime shtese per shitjen.

### **3 Politika kontabel te rendesishme (vazhdim)**

#### **3.9 Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar konsiston ne mjetet monetare te kontribuara nga themeluesit e shoqerise. Kapitali aksionar paraqitet me vleren ne Lek te konvertuar me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Kapitali aksionar i shoqerise njihet me vlere nominale.

#### **3.10 Njohja e te ardhurave**

Sipas SNRF 15 te ardhurat njihen ne masen qe eshte pothuajse e sigurte se nje kthim ne sasine e te ardhurave te akumuluar te njohura nuk do te ndodhe. Keshtu e ardhura matet duke u bazuar ne shumen e percaktuar ne nje kontrate me klientin ose ne listen e cmimeve te Shoqerise. Shoqeria e njeh te ardhuren atehere kur ajo transferon kontrollin mbi sherbimin ose mallin tek klienti.

Shoqeria njeh te ardhuren ne nje pike ne kohe qe perfaqesohet nga momenti qe klienti pranon sherbimet ose mallrat e ofruara nga shoqeria si edhe merr persiper rreziket e ketij transferimi te sherbimeve ose mallrave, me supozimin se nuk do te kete kthime te rendesishme ne to.

#### **Shitjet e sherbimeve:**

Te ardhurat njihen gjate kohes kur ofrohen sherbimet. Faza e perfundimit per percaktimin e shumes se te ardhurave per t'u njohur vleresohet bazuar ne anketat e punes se kryer. Nese sherbimet sipas nje marreveshjeje te vetme jepen ne periudha te ndryshme raportimi, atehere shuma ndahet ne baze te çmimeve te tyre te shitjes.

Pasqyra e meposhtshme jep te dhena ne lidhje me natyren dhe kohen e permbushjes se detyrime kontraktuale me klientet, perfshi termat kryesore te pageses dhe politikat Politikat e njohjes se te ardhurave.

<b>Lloji i mallit /Sherbimit</b>	<b>Natyra dhe koha e permbushjes se kerkesave te arketueshme kontraktuale perfshi termat kryesore te pageses</b>	<b>Politikat e njohjes se te ardhurave</b>
Shitja e sherbimeve	Klientet perfitojne sherbimin kur ata e marrin ate.  Faturat perkatese gjenerohen ne kete moment ne kohe.	Shoqeria e njeh te ardhuren atehere kur ajo transferon kontrollin mbi sherbimin ose mallin tek klienti.

#### **3.11 Perfitimet e punonjesve**

##### **Kontributet e detyrueshme per sigurime shoqerore**

Gjate ushtrimit te aktivitetit operativ, shoqeria kryen pagesa periodike per llogari te punonjesve per pjesen qe ligjerisht i takon te paguaje shoqerise dhe punonjesve per te kontribuar per fondet e detyrueshme te pensioneve sipas rregullimeve te legjislacionit vendas. Kostot e shoqerise jane perfshire ne llogaritjen e rezultatit te periudhes.

#### **3.12 Tatim fitimi i vitit dhe tatim fitimi i shtyre**

Shpenzimet per tatim fitimin perfshijne tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyre. Shpenzimet per tatim fitimin njihen ne fitim ose humbje deri pervec pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital ose ne te ardhurat e tjera permbledhese.

Tatimi mbi fitimin aktual eshte tatimi i pagueshem mbi te ardhurat e tatueshme duke perdorur normat e taksimit ne daten e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit te pagueshem te lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshem eshte 15% e fitimit te tatueshem.

### **3 Politika kontabel te rendesishme (vazhdim)**

#### **3.12 Tatim fitimi i vitit dhe tatim fitimi i shtyre (vazhdim)**

Tatim fitimi i shtyre njihet ne lidhje me diferencat e perkohshme midis vleres kontabel te aktiveve dhe detyrimeve per qellime te raportimit financiar dhe vlerave te perdorura per qellime tatimore. Tatimi i shtyre matet me normat tatimore qe pritet te aplikohen per diferencat e perkohshme kur ato ndryshojne. duke u bazuar ne ligjet qe kane qene ose jane ne fuqi ne daten e raportimit.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet ne masen qe eshte e mundur qe fitime te ardhshme te tatueshme do te jene ne dispozicion per te mbuluar diferencat e perkohshme. Aktivet tatimore te shtyra rishikohen ne çdo date raportimi dhe reduktohen ne qofte se perfthimet tatimore nuk do te jene me te mundshme per tu realizuar.

#### **3.13 Aktive ne perdorim dhe qiraja financiare**

Ne fazen fillestare te qirase, shoqeria vlereson nese kontrata eshte ose permban nje qira. Kontrata eshte ose permban nje qira, nese kontrata jep te drejten e kontrollit mbi perdorimin e nje aktivi te identifikueshem per nje periudhe kohe ne kembim tevnje shume. Per te vleresuar nese kontrata eshte ose permban te drejten e kontrollit te perdorimit ten je aktivi te identifikueshem, shoqeria perdor perkufizimin e qirase sipas SNRF 16. Kjo politike eshte aplikuar per kontrata te cilat kane hyre ne fuqi ne dhe me pas se 1 janar 2019.

##### **Si nje qiramarres**

Ne fazen fillestare ose pergjate ndryshimit te nje kontrate e cila permban nje qira, shoqeria shperndan shumen ne kontrate tek secili perberes qira mbi bazen e cmimit specific perkates te perberesit qira. Gjithsesi, per qirate e ndertesave, shoqeria ka zgjedhur te mos i vecoje perberesit jo-qira nga perberesit qira dhe ta trajtoje secilin perberes qira dhe ndonje perberes jo-qira te lidhur me te si nje perberes te vetem qiraje.

Ne daten e fillimit, shoqeria ka njohur nje aktiv me te drejte perdorimi dhe nje detyrim te qirase. E drejta per te perdorur activin eshte njohur me kosto, e cila perfshin shumen e matjes fillestare te detyrimit te qirase, te axhustuar per pagesat e qirase te kryera perpara ose ne daten e fillimit, plus cdo kosto fillestare te drejteperdrejte te kryer nga qiramarresi, dhe nje vleresim te kostove qe do te ndodhin nga qiramarresi per cmontim dhe levizjen e aktivitet baze, restaurimi I aktivitet baze ne kushtet e kerkuara, minus cdo stimul qiraje te marre.

Aktivi me te drejte perdorimi eshte amortizuar bazuar ne metoden lineare prej dates se fillimit te qirase deri ne fund te periudhes se qirase pervec nese qiradhenesi transferon pronesine e aktiviteti baze te shoqeria ne fund te afatit te qirase ose kosto e aktivitet me te drejte perdorimi reflekton se qiramarresi do te ushtroje nje opsion blerje. Ne kete rast aktivitet me te drejte perdorimi do te amortizohet nga data e fillimit deri ne fund te jetes se dobishme te aktivitet baze, e cila percaktohet ne te njejte baze si aktivitet afatgjata materiale. Pervec kesaj, aktivitet me te drejte perdorimi do te zvogelohet per zhvleresime nese ka, dhe axhustuar per te reflektuar cdo modifikim te detyrimit te qirase.

Ne daten e fillimit, detyrimi i qirase eshte njohur me vleren aktuale te pagesave te qirase, te cilat nuk jane paguar ende ne ate date, te skontuara duke perdorur normen e interesit te percaktuar te qirase, nese kjo norme nuk mund te percaktohet lehte, perdoret kosto e huamarrjes se shoqerise. Pergjithesisht, Shoqeria perdor normen e interesit te huamarrjes si norme skontimi.

Shoqeria ka percaktuar normen rritese te huamarrjes duke marre normat e interesit nga disa burime financimi te jashtme dhe duke e axhustuar per te reflektuar temat dhe kushtet e aktiveve te marra me qira. Pagesat e qirase perfshin pagesat fikse, duke perfshire pagesat fikse ne thelb te qirase. Detyrimi i qirase eshte vleresuar me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

### **3 Politika kontabel te rendesishme (vazhdim)**

#### **3.13 Aktive ne perdorim dhe qiraja financiare (vazhdim)**

##### **Qirate afatshkurtra dhe qirate per aktive me vlere te ulet**

